



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 53.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Udhëzimin Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenin 49 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e datës 31 tetor 2022, përkatësisht në vazhdimin e mbledhjes më 07 nëntor 2022, mori këtë,

V E N D I M

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komitetit për Komunitete, sipas Vendimit nr.prot.01-020/02-0030731/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, të datës 29 prill 2022, me ndryshim plotësimin sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-0062844/22 të datës 29 korrik 2022, dhe atë:

- **z.Florent Hasani**, anëtar i Kuvendit të Komunës nga radhët e LVV, emërohet anëtar i Komitetit për Komunitete, në vend të z.Haki Rudari, i cili ka dhënë dorëheqje nga cilësia e anëtarit të Komitetit për Komunitete, përkatësisht është emëruar anëtar në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Neni 2

Ky Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit nr.prot.01-020/02-0030731/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, të datës 29 prill 2022, me plotësim ndryshimet sipas Vendimit nr.prot.02-020/04-0062844/22 të datës 29 korrik 2022.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren QRK nr.06/2021.

Nr.prot. 01-020/04-0093813/22
Podujevë, datë; 07 nëntor 2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 51.1 dhe 53.1, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenet 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, 47 paragrafi 1 dhe nenin 49 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Sipas Shkresës së Ministrisë së Pushtetit Lokal nr.020-201/14 të datës 29.03.2022, për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, pas rishqyrtimit të aktit, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2022, mori këtë,

VENDIM PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

Themelohet Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

- 1- Qëndresë Hajrizi, anëtare nga radhët Kuvendit të Komunës-LVV
- 2- Haki Rudari, anëtar nga radhët Kuvendit të Komunës-LVV
- 3- Demokrat Hodolli, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës-LDK
- 4- Arbnor Fazliu, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës-AAK
- 5- Albina Avdiu, anëtare nga radhët e Komunitetit Ashkali
- 6- Xhafer Ademi, anëtar nga radhët e Komunitetit Ashkali
- 7- Shkurte Sejdiu, anëtare nga radhët e Komunitetit Ashkali
- 8- Muhamet Sadiku, anëtar nga radhët e Komunitetit Rom
- 9- Sevdije Mustafa, anëtare nga radhët e Komunitetit Egjiptian

Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlidhet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual, bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Komitetit për Komunitete, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit, rregulloren e punës së Komiteteve, dhe dispozitat tjera përkatëse në fuqi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021

Nr.prot. 01-020/02-0030731/22
Podujevë, datë, 29 prill 2022



Kryetari i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 53.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Udhëzimin Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenit 12 paragrafi 1 të Rregullores (MAPL) 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenin 49 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2022, mori këtë,

VENDIM

Neni 1

1. Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komitetit për Komunitete, sipas Vendimit nr.prot.01-020/02-0030731/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, të datës 29 prill 2022, dhe atë:

- 1.1. znj.Naile Ahmeti, (komuniteti ashkali) emërohet në vend të znj.Albina Avdiu, e cila ka dhënë dorëheqje nga cilësia e anëtares së Komitetit për Komunitete.
- 1.2. z.Selver Rama, (komuniteti rom) emërohet në vend të z.Muhamet Sadiku, i cili ka dhënë dorëheqje nga cilësia e anëtarit të Komitetit për Komunitete.

Neni 2

Ky Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit nr.prot.01-020/02-0030731/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, të datës 29 prill 2022.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren QRK nr.06/2021.

Nr.prot. 01-020/04-0062844/22
Podujevë, datë; 29 korrik 2022



kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha